

## COVID 19. REFLEKTIME

**Shahe Tota**

**VITI I 2-të, finance, bankë dhe kontabilitet, UMSH**



Në ditët e para të Janarit dëgjoj për një virus që kishte ‘pushtuar’ Kinën. Ndër mendimet e para: Eh, Kina është shumë larg, bota ka përparuar, shkenca ka ecur përpara dhe nuk do të lejojë që ky virus të vijë në Europë apo të përhapej në gjithë botën. Gjithsesi, fatkeqësisht ‘bota’ ndoshta mund të kishte qënë e përgatitur për një luftë të tretë, për armë bërthamore, armë kimike por, jo për një luftë me një të ‘panjohur’. Dhe pra, u zhgënjeva, mendimi që bota ka përparuar shumë; fillimisht kisha ndjesi negative, mendime mbytëse dhe, në këtë rast ‘bota’ nuk ka përparuar, Virusi Korona PO. Koronavirusi përparoi, eci shumë para duke prekur Europën, Amerikën, Australinë duke na bërë ne njerëzve të ‘STOPOHEMI’. Çdo ditë ky virus po merrte qindra jetë njerëzish në Italinë tone fqinje, duke na e konkretizuar dhe më shumë atë që dikur e dëgjuam nga ‘atje larg’. Pas lajmeve të kobshme edhe vendit tim i erdhi radha të izolohej, të mbyllë kufijtë shtetërorë dhe derën e shtëpisë. Duhet të dalim vetëm për raste të domosdoshme. Ky virus na mbylli në shtëpinë që prindërit tanë e kanë ndërtuar me shumë mund, por që ne kurrë nuk kishim ndenjur dhe shijuar kaq shumë. Kam filluar ta pi kafen me mamin dhe babin në shtëpinë time të dashur...sa më shijon! Në fakt, në fillim mendova se do mërzhitesha dhe do ishte e pamundur të rrija në shtëpi. Ditët e para më dukeshin shumë mbytëse, pasi rrija dhe mendoja vetëm anë negative të pandemisë që pushtoi botën. Pas shumë mendimeve negative dhe të errëta më duhet të them që ka pasur dhe anë çuditërisht pozitive. Çuditërisht PO! Shumë ironike ë, dikur kur një vend pushtohet nga armiku duhet që në luftë të dilnin sa më shumë ushtarë. E tani për të luftuar këtë armik që pushtoi botën tonë duhet të rrimë sa më shumë brenda në shtëpitë tona, të ruajmë distancën fizike, të shtojmë kujdesin e higjienës, të ushqehemi sa më shëndetshëm me shumë fruta, lëngje etj. Në fillim thash njerëyimi STOP-oi, por JO NATYRA! Ajo filloi të ketë një bum lulëzimesh që na ngrohën zemrën. Duke qënë se njerëzimi u detyrua të mbyllej brenda me familjet e tyre, Natyra u çlirua duke na falur ajrin e pastër. Ndoshta bota kishte nevojë për pak pushim, për pak qetësi. Kishim filluar ta jetonim jetën duke vrapuar. Kishim filluar të harronim të interesoheshim për të afërmit tane, për shëndetin e tyre. Ehh, po e quanim individualizëm, por tani më duket sikur ishte shumë afër egoizmit. Tani duket sikur distancimi fizik i riafroi njerëzit, u rizgjuan ‘shqisat’ e ndjeshmërisë dhembshurisë. Tani në familjen time, por besoj se edhe në të gjitha familjet shqiptare, ne flasim më shpesh me të afërmit tanë, i telefonojmë më shpesh. i pyesim ata, interesohemi për gjëndjen shëndetësore dhe i këshillojmë të tregojnë sa më shumë kujdes. Ky virus ka marrë vëmendje shumë të madhe dhe po na frikëson vërtet shumë, por unë dua ti shoh anë pozitive. Pas shiut lind gjithmonë dielli. Le të shpresojmë që vaksina e këtij virusi të zbulohet sa më shpejt, e ndërkohë këto ditë ‘shiu’ që jemi të mbyllur ti shfrytëzojmë që të përvetësojmë njohuritë tona, të lexojmë sa më shumë e të thejxojmë karantinën e mëndjes, të zgjerojmë horizontin, atje nuk na vendosin dot kufinj. Dhe kur dielli të lindë të na gjejë me zemrën e mbushur me dashuri dhe me mendje të hapur. Durim dhe kujdes, DO JA DALIM!